



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.970/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit “V.....” SH.P.K., me seli në S....., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit K..... SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit NGB “Z...” SH.P.K., me seli në Pr....., me objekt kontesti shpifje, vlera e kontestit 5,000.00 €, jashtë seancës, më datën 19.06.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë së paditësit “V.....” SH.P.K., me numër të lëndës KE.nr.970/22 (C.nr 1450/20; 2020:045819) të datës 01.04.2020, kundër të paditurit paditurit NGB “Z...” SH.P.K., me objekt kontesti shpifje, vlera e kontestit 5,000.00 €.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi “V.....” SH.P.K., me datë 01.04.2020, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit i Përgjithshëm, kundër të paditurit NGB “Z...” SH.P.K., me objekt kontesti shpifje, vlera e kontestit 5,000.00 €.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e

Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: “Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”, vlerëson se çështjet që kanë të bëjnë me shpifje dhe fyerje, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkak se shpifja dhe fyerja, nuk hyn në kuadër të çështjeve të ndërsjella tregtare dhe as çështjeve tjera që ndërlidhen me raportet afariste në mes tyre, ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.970/22, datë 19.06.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate